

KUSHTET E PERGJITHSHME TE KONTRATES PER SIGURIMIN E BUJQESISE

Depozita te pergjithshme

1. Kushtet e Pergjithshme te Kontrates per Sigurimin ne bujqesi, ketu me poshte do te quhen shkurtimisht "Kushte sigurimi".
 - 1.1. SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a., ketu me poshte do te quhet shkurtimisht "Siguruesi"
 - 1.2. Personi fizik ose juridik, interesi pasuror i te cilit do te mbulohet me Sigurim, ketu me poshte do te quhet shkurtimisht "I Siguruari".
 - 1.3. Personi fizik ose juridik, qe ka interes pasuror mbi objektin e siguruar dhe ne dobi te te cilit lidhet kontrata, këtu më poshtë do të quhet "Përfituesi".

Objekti i Sigurimit

2. Siguruesi ofron mbulimin ne sigurimin per:
 - 2.1 Te gjitha llojet e kulturave bujqesore.
Siperfaqja e siguruar per secilen kulture duhet te jete jo me e vogel se 1 dynym (1000 m²).
 - 2.2 Sigurimi mbulon humbjen dhe demtimet sasiore te prodhimit kryesor.
 - 2.3. Sigurimi mbulon demtimin e drufrutoreve (Nr. Rrenje) ne rritje dhe ne prodhim.

Rreziket e Sigurimit

4. Rreziku i sigurimit eshte ngjarja e papritur dhe e paparashikuar.
Siguruesi mbulon rrezikun e sigurimit:
 - 4.1 -Bresheri.
Me bresher kuptohen reshjet qe formohen nga pikat e shiut te ngrira si akull ne ajer dhe qe bien ne forme kokrrash.
Demitimet qe u shkaktohen kulturave bujqesore nga bresheri jane te ndryshme:
goditje e plote ose e pjesore e kallirit,coptimi ose thyerja e kallirit ,carja ne mes e bimes,keputja e plote ose e pjesshme e gjethes,cpuarja e gjethes,keputja dhe coptimi i filizave, goditja e luleve dhe e frutave, plagosja e frutave, trupit te bimes dhe demtime te tjera te saj.

Rreziqe shtese te sigurimit

5. Siguruesi mbulon edhe rreziket shtese te sigurimit si me poshte:
 - 5.1 - Stuhia.
Me stuhi kuptohet era e vrullshme dhe e shpejte me shpejtesi mbi 60 km/oreqe mund te shoqerohet me reshje.

Stuhia i shkakton bimeve demtime mekanike ne formen e thyerjes se kallinjve, fleteve,por shpesh ne vende te larta shkakton gerryerjen e pjeses se sipërme te sipërfaqes dhe zbulimin e sistemit te rrenjeve, kurse ne vendet e ulta mbushjen e bimeve me pjese te vogla te sipërfaqes.

5.2 - Shtrengata.

Me shtrengate kuptohet shiu i rrembyer shoqeruae me ere te fuqishme.

Shtrengata shtrin perdhe te mbjellat e rritura, rrezon frutet, thyen deget e pemeve ose i rrezon pemet perdhe, mbulon te mbjellat me rere dhe me toke, shkul nga rrenjet bimet e njoma dhe te paforcuar.

5.3- Permbytja.

Me permbytje kuptohet mbulimi teresisht i sipërfaqeve te mbjella nga ujerat si rezultat i vershimit te lumenjve ose perrenjve. Cdo permbytje shkaktohet nga ndonje shkak tjetër, perben nje rrezik per te cilin Siguruesi nuk mban pergjegjesi.

Kur kulturat bujqesore qendrojne te permbytura me shume se 24-ore nga permbytjet ndodhin demtime vatra-vatra ose te plot ate bimeve te mbjella. Bimet e demtuara marrin ngjyre te verdhe dhe te zbehte.

Rreziqet shtese te sigurimit te sipërpermendura, do te mbulohen vetem ne qofte se permenden shprehimish ne policen e sigurimit dhe eshte paguar primi shtese i tyre.

Mbulimi ne sigurim

6. Ky sigurim mbulon prodhimin bujqesor te siguruar vetem per nje cikël prodhimi te kulturave te para.Mbulimi ne sigurim fillon pas lidhjes se kontrates se sigurimit por jo me pare se:

- 1-Nga momenti i mbjelljes,per kulturat qe mblidhen ne fidane;
- 2-Nga momenti i celjes se luleve,per agrumet,per ullinjt dhe peme te tjera frutore;
- 3-Nga momenti i celjes se sytheve, per vreshtat
- 4-Nga momenti i daljes ne sipërfaqe (mbirjes) per kulturat e tjera.

Rimbjellja

7. Kur kultura bujqesore e siguruar eshte demtuar ne nje mase te tille qe sipërfaqja e saj duhet te rimbillet ne ate apo ne nje kulture tjetër te te njejtës stinë qe ka qene mbjelle kultura e demtuar, demshperblimi behet ne perqindje mbi shumen e siguruar ne mase qe vijon:

- a) Per pambukun, lulen e diellit dhe panxharin e sheqerit 20%.
- b) Per duhanin 30%.
- c).Per kulturat e tjera 40%.

Kulturat e mbjella pas demtimit mund te sigurohen duke lidhur kontrate te re sigurimi.

Kur ne baze te deshmise se organeve kopetente te rrethet vertetohet se per shkak te kohes jo te favorshme rimbjellja nuk mund te behet brenda stines shperblimi paguhet perkatesisht me nje shtese +20% ndaj pikave (a,b,c).

Pushimi i mbulimit ne sigurim

8. Sigurimi pushon ne momentin:

- a) Kur ky prodhim eshte korrur ose vjelur;

- b) Kur mbi bazen e kushteve dhe rregullave agroteknike, duhet te kishte filluar vjelja ose korrja e prodhimit bujqesor te siguruar;
- c) Kur siperfaqja e siguruar kalon ne pronesi tek nje person tjetër. Ne kete rast kontrata e sigurimit quhet e zgjidhur dhe primi i paguar i kthehet te siguruarit ne perpjestim me kohen qe mbetet qer ne mbarim te afatit te sigurimit.

Perjashtimet

9. Perjashtohen nga mbulimi ne sigurim rastet kur:

- a) Demet shkaktohen per faj ose pakujdesi te rende te te siguruarit, perfaqesuesit te tij ose nje personi te familjes se tij;
- b) I siguruari nuk ka zbatuar masat agroteknike te domosdoshme te pershkruara ne marrveshje;
- c) demet shkaktohen nga lufta, invazioni, veprime te armikut te jashtem, veprimet luftarake (panvarsisht nese eshte shpallur lufta ose jo), lufta civile, rebelimi, kryengritja, trazirat, grevat;
- d) Demet shkaktohen me urdhera te autoriteteve shteterore;
- e) Demi shkaktohet nga shperthimet ose rrezatimet berthamore.
- f) Demet nga kafshet, zogjte ose nga nderhyrje e te treteve ne punime e veprime qe sjellin pasoja ne demtimet e mundshme te kultures se kontraktuar.

Shuma e siguruar

10. Shuma e siguruar percaktohet sipas marrveshjes midis Sigurveesit dhe te Siguararit.

Llogaritja e shumes se siguruar behet duke shumezuar madhesine e siperfaqes se kultures se siguruar me normen e sigurimit per cdo hektar. Norma e sigurimit per cdo hektar llogaritet ne baze te rendimentit mesatar shumezuar me cmimin mesatar te fermave ne vitin e meparshem. Norma e sigurimit per cdo hektar te kulturave bujqesore llogaritet sipas Aneksit Nr.1 bashkangjitur Kushteve te Sigurimit

Tarifa

11. Tarifat e primit te sigurimit jane fikse dhe te percaktuara per cdo kulture ose kultura bujqesore ne Aneksin Nr.1 bashkangjitur Kushteve te Sigurimit.

Tarifat e primit te sigurimit, per cdo rrezik shtese percaktohet ne Aneksin Nr.1 te siperpermendur dhe i shtohet tarifes sipas paragrafit te pare te ketj neni.

Primi i sigurimit

12. Primi i sigurimit llogaritet duke shumezuar tarifen e sigurimit me shumen e siguruar te rene dakort midis Sigurveit dhe te Siguararit. Primi i sigurimit paguhet teresisht ose me dy keste te barabarta.

Primi ose kesti i pare paguhet ne kohen e dorezimit te polices se sigurimit.

Ne rastin e pagimit te primit te sigurimit me dy keste, kesti i dyte i tij paguhet jo me vone se 60 dite nga data e pagimit te kestit te pare.

Kur kesti I dyte nuk paguhet Brenda 15 diteve pas afatit te mesiperm atehere:

- a) Sigurveesi ka te drejte te zgjidhe kontraten e sigurimit ;
- b) Humbjet dhe demtimet e vertetuara pas afatit 15 ditor, nuk demshperblehen.

Kur demi ndodh para se te paguhet kesti i dyte i primit, shuma e demshperblimit jepet e plote, por zbritet kesti i dyte i primit i papaguar.

Franshiza

13. Sigurimi nga bresheri nuk mbulon humbjen dhe demtimet qe jane me te vogla se :

- a) -3% te shumes se siguruar per grurin , thekren, elbin, jonxhen,
- b) -5% te shumes se siguruar per orizin, misrin, sojen, lulediellin, pataten,panxharin;
- c) -8% te shumes se siguruar per kulturat e tjera bujqesore.

Perqindja e siperpermendur, sipas rastit,caktohen ne policen e sigurimit.

Pjesa e zbritshme

14. Perqindja prej 8-15% e humbjes ose demtimit qe eshte e papagushme dhe qe tregohet ne policen e sigurimit, perben pjesen te zbritshme kundrejt vleres se demshperblimit per tu paguar per cdo rast sigurimi te vertetuar.

Kontrata e sigurimit

15. Kontrata e sigurimit lidhet ne cdo kohe te vitit per nje periudhe prej nje viti bujqesor me kushtet qe te sigurohen te gjitha siperfaqet e parashikuara, ose te mbjella efektivisht me te njeten kultur. Kulturat e demtuara si dhe ato qe ndodhen ne siperfaqe ose ne parcela ku kercenohen nga ndonje rrezik i gatshem , nuk sigurohen.Perjashtohen nga sigurimi edhe kulturat bujqesore ne ato siperfaqe ku te njejtat fenomene shkaterrimtare te natyres veprojne shpesh ose ne menyre te perseritur.

Kontrata e sigurimit te kulturave bujqesore mund te lidhet edhe me bleresit e prodhimit te tyre ose me kreditorët, por me kusht qe kesti i pare i primit te sigurimit te paguhet ne kohen e lidhjes se kontrates se sigurimit, ndersa kesti i dyte i primit paguhet brenda 10 diteve pas korrjes ose vjeljes se prodhimit.

Kur kesti i dyte i primit nuk eshte paguar brenda 10 diteve nga data e vlejës ose korrjes se prodhimit bleresi eshte i detyruar te paguaj 20% me shume mbi shumen e primit te kestit te dyte.

Kontrata e sigurimit hyn ne fuqi ne oren 24 te dites se perfundimit te kontrates qe mbaron ne oren 24 te dites se fundit te kohezqatjes se kontrates. Kontrata e sigurimit konsiderohet e lidhur kur deshmia (policia) e sigurimit i dorezohet te siguruarit kundrejt arketimit te primit teresisht ose pjesisht, sic parashikohet ne kontrate.

Polica e sigurimit

16. Polica e sigurimit leshohet mbi bazen e kerkeses me shkrim te te Siguararit.

Siguruesi leshon policen e sigurimit dhe percakton primin e sigurimit ne baze te njoftimeve dhe deklarimeve te bera nga i Siguarari.

Siguruesi ka te drejte te verifikojë vertetesine dhe sakesine e njoftimeve dhe deklarimeve te te Siguararit.

I Siguarari, mban pergjegjesi te plote per sakesine dhe vertetesine e njoftimeve dhe deklarimeve te bera prej tij.

17. Polica e sigurimit hyn ne fuqi ne oren 24 te dites se arketimit te primit ose kestit te pare te primit te sigurimit nga Siguruesi.

18. Siguruesi ose I Siguarari kane te drejte te heqin dore nga polica e sigurimit deri ne momentin e fillimit te mbulimit ne sigurim sipas nenit 6 te mesiperm duke bere njoftim me shkrim.

Polica e sigurimit do te quhet e zgjidhur ne momentin e marrjes se njoftimit me shkrim sipas paragrafit me lart. I Siguruari ka te drejten e kerkimit te primit ose kestit te pare te paguar, ndersa Siguruesi ka te drejten e kerkimit te shpenzimeve te bera per lidhjen e polices se sigurimit.

19. Polica e sigurimit mbetet ne fuqi per nje afat 15 ditor edhe pas dites se fillimit te detyrimit per pagimin e kestit te dyte te primit te sigurimit.

Deklarime te pasakta

20. Ne rast se madhesia e siperfaqes se mbjelljes per cdo culture te siguruar, eshte e ndryshme nga ajo e treguar ne policen e sigurimit, edhe primi i sigurimit do te rillogaritet ne varesi te ketij ndryshimi. Siguruesi dhe i Siguruari eshte i detyruar perkatesisht te ktheje ose te paguaje diferencen e primit te sigurimit. Kur i siguruari nuk paguan diferencen e primit te sigurimit, shuma e sigurimit e shenuar ne police zvogelohet ne perpjestim me masen e primit te paguar.

21. Siguruesi ka te drejte te zgjedhe kontraten e sigurimit ne rast se ka rrethana te tilla qe ; po te dinte Siguruesi nuk do te kishte lidhur kontraten. Ne kete rast primit e sigurimit deri ne kohen qe kerkohet prishja e kontrates, nuk i kthehen te Siguararit.

Njoftim i ngjarjes se sigurimit

22. I Siguruari eshte i detyruar te njoftoje me shkrim Siguruesin per cdo ngjarje sigurimi qe shkakton humbjen apo demtime ne prodhimin bujqesor te siguruar brenda 2 diteve duke perfshire edhe ditene e ndodhjes se ngjarjes se sigurimit .Ne qofte se i Siguruari nuk ben kete njoftim, Siguruesi ka te drejte te mos paguaj shperblimin e sigurimit ose shumen e sigurimit. I Siguruari eshte i detyruar te njoftoje me shkrim Siguruesin jo me pak se 10 dite perpara se te filloje korren ose vjeljen e prodhimit bujqesor. Ne rast kur prodhimet bujqesore rrezikohen per tu demtuar me tej, I Siguruari eshte i detyruar te ruaje kampionet e prodhimit per cdo parcele per te verifikuar, ekspertuar humbjen ose demtimin. I Siguruari ne rast te ndodhjes se ndonje demi duhet te marre te gjitha masat per te minimizuar demin.

Ekspertimi

23. Siguruesi, brenda 10 diteve nga njoftimi i te Siguararit, eshte i detyruar te filloj ekspertimin e prodhimit bujqesor te demtuar ose te humbur. Me kalimin e ketij afati i Siguruari ka te drejte te mos i permbahet kerkesave te nenit 21 te mesiperme.

Siguruesi ka te drejte te kryeje verifikime mbi prodhimin bujqesor te demtuar.

Siguruesi Brenda 24 oreve pas perfundimit te ekspertizes duhet ti beje te njohur te Siguararit rezultatet e akt-ekspertimit perfundimtar. I Siguruari ka te drejte te jete i pranishem gjate kryerjes se veprimeve te ekspertimit nga Siguruesi.

Riekspertimi

24. Ne rast kur i Siguruari nuk pranon pjesisht ose plotesisht akt-ekspertimin e Siguruesit, e njofton ate me shkrim brenda 2 diteve nga marrja e keti akti. Kur ka mosmarrveshje midis tyre te dy palet caktojne nje ekspert tjeter ose nje grup ekspertesh te perbere nga perfaqesues te tyre ose te trete.

Eksperti ose grupi i eksperteve te lartpermendur nuk kane te drejte te riekspertojne ose te vazhdojne riekspertimin e filluar kur ne te njejten siperfaqe te demtuar vertetohet nje humbje ose demtim tjeter i prodhimit bujqesor te siguruar. Ne kete kushte procedura e ekspertimit do te rifillonte sipas nenit te mesiperm.

Kerkesa per demshperblim

25. Siguruesi paguan demshperblim mbi bazen e akt-ekspertimit perfundimtar dhe vetem ne qofte se i paraqitet kerkesa me shkrim per demshperblim nga i Siguruari.

Siguruesi paguan ose refuzon me shkrim pagimin e demshperblimit brenda 30 diteve nga dita e marrjes se kerkeses per demshperblim.

Siguruesi ka te drejten te kerkoje kthimin e shumes se paguar nga personat qe jane pergjegjes per shkaktimin e demit.

Gjithashtu nga shuma e demshperblimit te kuturave bujqesore zbriten demshperblimi per demet qe jane shkaktuar nga rreziqe per te cilat kultura nuk ka qene e siguruar, demtimet e shkaktuara nga moszbatimi i rregullave agronomike ose per faj ose pakujdesi te rende te te Siguruarit, perfaqesuesit ose nje personi te familjes se tij dhe humbjet nga rendimenti.

Demshperblimi

26. Siguruesi pergjigjet per demtimet ose humbjet qe vertetohen gjate periodhes se mbulimit per sigurim, por shuma e pergjithshme e demshperblimeve nuk mund te jete me e madhe se shuma e siguruar e treguar ne policen e sigurimit.

27. Kur humbja ose demtimi i prodhimit bujqesor te siguruar eshte i pjesshem, demshperblimi jepet ne baze te shumes se siguruar sa eshte perqindja e demit te shkaktuar nga rreziqet per te cilat eshte lidhur kontrata e sigurimit.

Dispozita te tjera

28. Per mosmarrveshjet qe lind mes paleve kur ato nuk zgjidhen me mirekuptim zgjidhen nepermjet Gjykates qe i perket vendit ku eshte lidhur kontrata.

29. Pervec sa eshte parashikuar shprehimisht ne dispozitat e ketyre Kushteve te Sigurimit, do te zbatohen dispozitat e Kodit civil apo akteve ligjore e nenligjore qe lidhen me sigurimet.